



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1721 Prot

Tiranë, më 30/10/2019

REKOMANDIM

Nr. 54, datë 30/10/2019

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS  
SË AUTORITETIT PUBLIK “KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË ”

Në mbështetje të neneve 6, 7 të Ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare <https://klp.al/programi-i-transparences/>, të Autoritetit Publik “Këshilli i Lartë i Prokurorisë ” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Autoritetet Publike bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni.

Gjithashtu, bazuar në pikën 2 të po të njëjtës dispozitë, në përgatitjen e programit të transparencës, Autoriteti Publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

- a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
- b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
- c) modelet e miratuara për kategorinë e Autoritetit Publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet

përditësimin dhe pasurimit të vazhdueshëm të Programit të Transparencës, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo Autoritet Publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të ligjit të sipërcituar.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj, u krye monitorimi me qëllim verifikimin e zbatimit të programit të transparencës në faqen zyrtare të Autoritetit Publik. Nga monitorimi rezultoi se, Autoriteti Publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore menu-në “Legjislacion” në të cilën programi i transparencës shfaqet si një nën menu por, nuk rezulton i ndërlidhur/i aksesueshëm.

Duke qenë se nuk është publikuar programi i transparencës, për rrjedhojë verifikimi i rubrikave të tij nuk është i mundur.

Programi i transparencës duhet të jetë i plotësuar me të gjithë elementët sikurse parashikohet në ligj, si dhe i plotësuar me informacion specifik sipas fushës së veprimtarisë së çdo Autoriteti Publik.

Në lidhje me detyrimin për publikimin e kategorive të informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik pa kërkesë në përputhje me nenin 7 të ligjit, u krye monitorimi në tërësi i faqes zyrtare të Autoritetit Publik.

Përsa i përket monitorimin të kryer Zyra e Komisionerit vlerëson se, problematikat e evidentuara konsistojnë në mosvënien në zbatim të programit të transparencës, në përputhje me modelin e miratuar nga Komisioneri.

Nga monitorimi u konstatua gjithashtu se as në faqen zyrtare të autoritetit nuk është publikuar informacioni në përputhje me nenin 7 pika 1 e ligjit, konkretisht për gërmat:

*ç) emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;*

*dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;*

*e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik 3 vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;*

*ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për*

koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;

g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji;

k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;

l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.

Disa kategori të informacionit publik sipas kërkesave të nenit 7 pika 1 e ligjit, gjenden të publikuara pjesërisht në faqen zyrtare të autoritetit. Konkretisht si më poshtë:

a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik; b) tekste të plotë: i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë;

c) procedurat e ankimit të vendimit përkatës;

d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë;

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi, u hartua raporti i monitorimit.

Komisioneri vlerëson se, Autoriteti Publik duhet të vërë në zbatim një program institucional të transparencës, ku të përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen

publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni, në përputhje me programin model të transparencës të miratuar nga Komisioneri.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar,

#### REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik/Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në zbatim të gërmave a), b), c) të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të vendos në zbatim programin institucional të transparencës;
2. Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit;
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 90 (nëntëdhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni;
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 30.10.2019

KOMISIONERI

Besnik Dervishi



## Raport monitorimi mbi implementimin e programit të transparencës së Autoritetit Publik/ Këshilli i Lartë i Prokurorisë – datë 12.10.2019


1. **Këshilli i Lartë i Prokurorisë** ka publikuar programin e transparencës në faqen zyrtare në linkun: <https://klp.al/programi-i-transparences/>.

Nga monitorimi i faqes rezulton se, autoriteti publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore menu-në “Legjislacion”, në të cilën Programi i transparencës shfaqet si një nën menu por, nuk rezulton i ndërlidhur programi.


Nga monitorimi i faqes zyrtare të autoritetit rezultoi se Programi i transparencës nuk është i publikuar në përputhje me programin model të transparencës të miratuar sipas Urdhërit nr.14 date 22.01.2015.

7.1.a) Një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.


**Informacioni gjendet pjesërisht i publikuar në faqen e autoritetit;**



7.1.b) tekstet e plota: i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë. **Informacioni gjendet pjesërisht i publikuar në faqen e autoritetit;**



7.1.c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës. **Informacioni është pjesërisht i publikuar në faqen e autoritetit;**



7.1.ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinаторit për të drejtën e informimit. **Informacioni është i publikuar pjesërisht në faqen e autoritetit (mungojnë të dhëna për koordinatorin):**

KONTAKT | KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Qendra e Sektorëve Zyrtarë

qkpaal/konтакт

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

TRETH NESH | NJOFTIME | SEANCA PLENARE | LEGJISLACION | KONTAKT | BKH

## KONTAKT

Adresa:

Rruga "Qemal Stafa" Nr.1 Tiranë

E-mail: info@kpaal

Tel: 042282000/1057

Emri (\*)

KERKO

Search...

NJOFTIME

Vendimet e marra në mbledhjen plenare të datës 11 Tetor 2019

NJOFTIM SEANCA PLENARE NR.32

NJOFTIM MBI REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR NGJETJE

12:26 AM 10/11/2019

7.1.d) një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime. **Informacioni gjendet pjesërisht i publikuar në faqen e autoritetit;**

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Qendra e Sektorëve Zyrtarë

qkpaal

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

TRETH NESH | NJOFTIME | SEANCA PLENARE | LEGJISLACION | KONTAKT | BKH

në vendet e meparshme të punës ose në pamundësi, në detyra të barasvlerëshme me to.


Neni 149/a

- Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron këto përgjegjësi:
  - a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve;
  - b) vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve;
  - c) i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, sipas ligjit;
  - d) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre;
  - e) propozon dhe administron buxhetin e tij;
  - f) informon publikun dhe Kuvendin mbi gjendjen e prokurorisë;
  - g) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.
- Ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve vendimmarrëse pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

LIGJ  
Nr. 115/2016  
PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË

Neni 101

12:26 AM 10/11/2019



7.1.dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit. **Informacioni nuk është i publikuar në faqen e autoritetit.**

7.1.e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara. **Informacioni nuk është i publikuar në faqen e autoritetit;**

7.1.ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;- **Informacioni nuk është i publikuar në faqen e autoritetit;**

7.1.f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit - **Informacioni nuk është i publikuar në faqen e autoritetit;**



7.1.g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik. **Informacioni është i publikuar pjesërisht në faqen e autoritetit;**

KËRKESË PËR INFORMACION

Emër Mbledhje: Z. Zoti _____	Adresa postare: _____	Data: ___/___/201__
	Adresa elektronike: _____	Naukëtar: _____
	Nr. Tel: _____	

Shprehjet e adresave elektronike të kërësve duhet të jenë në përputhje me adresat e kontaktimit të kërësve.

Përshkrim i detajuar i informacionit që kërkohet

Të tjera të shkurtra

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni:

Vatimi për përshkrimin e kërës

Data e marrjes: ___/___/201__	Numri i kërësve: _____	Komente: _____
-------------------------------	------------------------	----------------

7.1.gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik; - **Informacioni nuk është i publikuar në faqen e autoritetit;**

7.1.h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë; - **Informacioni nuk është i publikuar në faqen e autoritetit;**

7.1.i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji - **Informacioni nuk është i publikuar në faqen e autoritetit;**

7.1.k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh– **Informacioni nuk është i publikuar në faqe pavarësisht se citohet në tabelën e programit të transparencës;**

7.1.l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik . **Informacioni është i publikuar faqe dhe i ndërlidhur në tabelën e programit model të transparencës.**

<b>Autoriteti Publik</b>	Kolegji i Posaçëm i Apelit
Programi i transparencës	Jo
Koordinatori	Jo
7.1.aPërshkrim/struktura, funksionet dhe detyrate A.P	Pjesërisht
7.1.b Tekst. e plota të konventa, ligje, akteve	Po
7.1.c Procedura për kërkesë për informacion	Po
7.1.ç Të dhënat e vendodhjes së AP	Po
7.dTë dhënat për arsim.pagat	Jo
7.1.dh Auditi	Jo
7. 1.e Buxheti	Jo
7.ë Procedurat e Prokurimit	Jo
7.1.f Shërbimet e A.P	Jo
7.1.g Procedura për ankesë për veprimtarinë e AP	Jo
7.1.gj Mekanizma për dhënien e mendimeve	Jo
7.1.h Mbajtja e dok(Arkiva)	Jo
7.i Regjistri i kërkesave	Jo
7.1.k Dokumente që kërkohen shpesh	Jo
7.1.l Çdo Informacion i dobishëm	Jo